

UDHËZIM
Nr. 22, datë 18.11.2021

**PËR ZHVILLIMIN E TESTIMIT TË NXËNËSVE TË KLASAVE TË
BASHKUARA II–IX TË ARSIMIT BAZË, 2021**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të germës “a”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar” dhe vendimit nr. 523, datë 22.9.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”,

UDHËZIJ:

1. Zhvillimin e testimit të nxënësve të klasave të bashkuara II–IX, të arsimit bazë, më datë 6 dhjetor 2021.

2. Testimi i nxënësve të klasave të bashkuara II–IX të arsimit bazë është një vlerësim i njohurive gjuhësore në leximin dhe shkrimin e gjuhës shqipe dhe të njohurive matematikore.

3. Testimi i nxënësve të klasave të bashkuara II–IX, fillon në orën 10:00 dhe zgjat 60 minuta.

4. Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) caktojnë numrin e administratorëve përgjegjës për zhvillimin e testimit të nxënësve të klasave të bashkuara II–IX për çdo institucion arsimor parauniversitar, ku do të zhvillohet testimi.

5. Në çdo institucion ZVAP, procesi i testimit të nxënësve të klasave të bashkuara II–IX monitorohet nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP).

6. DPAP-ja monitoron procesin e tërheqjes dhe shpërndarjes së materialeve të provimit nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) në ZVAP-et përkatëse, një ditë para zhvillimit të testimit.

7. QSHA-ja kryen detyrat si më poshtë:

- a) harton testin e standardizuar dhe skemën e vlerësimit;
- b) shumëfishon dhe paketon të gjitha materialet e testimit dhe bën shpërndarjen e tyre;
- c) përpunon të dhënat, përgatit raportin mbi arritjet e nxënësve në testim dhe ia paraqet atë ministrit të Arsimit dhe Sportit.

8. DRAP/ZVAP kryen detyrat si më poshtë:

- a) dërgon në QSHA listën e institucioneve arsimore parauniversitare që kanë klasa të bashkuara dhe numrin e nxënësve për çdo klasë;
- b) tërheq nga QSHA-ja materialet e testimit një ditë përpara zhvillimit të testimit;
- c) udhëzon administratorët përgjegjës të çdo institucioni arsimor të caktojnë administratorët e testimit për çdo klasë dhe të menaxhojnë në kohë shpërndarjen dhe grumbullimin e testeve të nxënësve;
- d) organizon dhe kryen procesin e vlerësimit të testeve. Të dhënat dërgohen në formë elektronike në QSHA, DPAP dhe MAS deri në datën 23 dhjetor 2021;
- e) mban përgjegjësi për ruajtjen e sekretit dhe sigurimin e testeve deri në përfundim të procesit;
- f) kryen pagesën e vlerësuesve të testeve sipas legjislacionit në fuqi.

9. Udhëzimi nr. 3, datë 12.2.2019, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për zhvillimin e testimit të nxënësve të klasave të bashkuara II–IX të arsimit bazë 2019, shfuqizohet.

10. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, DRAP-et dhe ZVAP-et, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi